

I nderuar Kryetar i Akademisë
I nderuar Kryeministër i Republikës,
I nderuar Ministër Bajrami
Të nderuar kolegë dhe miq,
Të nderuar familjar të doktoreshës Dafina Bytyqi,
Zonja dhe zotërinj,

Komisioni i caktuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, që të vlerësojë kandidatët që kanë marrë pjesë në konkursin **“SHPËRBLIMI MBËSHTETËS 2016”**, për kandidatin e moshës së re që ka arritur rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës dhe të artit shqyrtoi dhe vlerësoi veç e veç dokumentacionin e prezantuar të kandidatëve të paraqitur në Konkursin e shpallur nga ASHAK, dhe vendosi njëzëri, që Shpërblimi mbështetës 2016 t’i ndahet kandidates nga fusha e mjekësisë, doktoreshës së shkencës biomekanike Dafina Bytyqi.

Disa të dhëna, shkurt, për kandidaten:

Dafina Bytyqi lindi në Prishtinë, më 27 maj 1986. Shkollën fillore dhe të mesme, e kreu në Prishtinë, me notë mesatare maksimale 5. Studimet universitare në mjekësinë e përgjithshme, i përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, në korrik të 2010-tës, me notë mesatare 9.65, kurse shkollën doktorale trevjeçare e përfundoi më 2015 në “Universitetin Lion 1” në Lion të Francës dhe mori gradën doktor shkence në biomekanikë. U doktorua në moshën 28 vjeçare dhe si e tillë konsiderohet kandidatja më e re me titullin doktor shkencë në Universitetin e Prishtinës në fushën e mjekësisë.

Ishte studente e dalluar e Universitetit të Prishtinës dhe pjesëmarrje në shumë projekteve shkencore-hulumtuese, rezultatet e të cilave i prezantoi në takimet dhe konferencat profesionale të kirurgjisë ortopedike në vend. Botoi një varg punimesh si autore dhe bashkautore, në revistat e njohura shkencore me faktor të lartë të ndikimit shkencor (impakt faktor).

Pas përfundimit të fakultetit, gjatë viteve 2010 – 2011, u angazhua asistente hulumtuese në Fondacionin e shëndetit të nënës dhe foshnjës, dhe asistente në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës në lëndën Fiziologji Patologjike ku gjendet edhe tani.

Krahas specializimit në kirurgji ortopedike, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ajo bëri praktikë klinike në kirurgji të gjurit nga 6 muaj në vjet, prej 2011-2015, në qendrën e ekselencës në Albert Trillat në Lion të Francës tek prof. Philippe Neyret.

Gjatë viteve 2008-2010, Dafina Bytyqi ishte vizitore shkencore dhe pjesëmarrëse në shumë trajnime e ligjërata në klinika të ndryshme universitare:

1. si në Universitetin e Manheim-it;
2. në Universitetin e Vjenës;
3. në Hannover, SHBA, ku bëri praktikë klinike, kryesisht në kirurgji të përgjithshme;

Kështu kandidatja Dafina Bytyqi ka bërë një punë solide profesionale e shkencore, në klinikat universitare në vend dhe jashtë tij, krahas ortopedëve të njohur vendorë e botërorë. Punimet e saja shkencore kryesisht janë nga fusha e ortopedisë.

Kandidatja Dafina Bytyqi edhe pse e moshës së re, në maj feston ditëlindjen e 30të, ka rezultate të dukshme profesionale dhe shkencore duke afirmuar punën profesionale dhe shkencore të vendit tonë në suaza ndërkombëtare.

Ajo është autore ose bashkëautore e një varg punimesh që janë rezultat i punës së palodhshme të saj, rezultate të cilat ajo i ka prezantuar në takime profesionale e shkencore në tubime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Kandidates Dafina Bytyqi bazuar në rezultatet dhe meritat e saj iu dhanë disa shpërblime përkatësisht iu ndan:

1. Vendi i parë në KISCOMS në 2008ën,
2. Studente e dalluar e Universitetit të Prishtinës në 2010ën,
3. Bursa për studime të doktoratës e Qeverisë franceze në 2011ën, dhe
4. Çmimi për Fellowship nga EFORT në 2013ën.

Mbështetur nga këto që u thanë më lartë, Komisioni ka kënaqësi të veçantë t’ia ndajë “Shpërblimin mbështetës 2016” dr. Dafina Bytyqit, specializante dhe doktor shkencë në biomekanikë, si mirënjohje për kontributin e saj në profesion dhe shkencë si një shtytje për punën e saj të mëtejme shkencore dhe profesionale.

Në Prishtinë, më 22 prill 2016.

Anëtarët e Komisionit:

1. Akademik Hivzi Islami
2. Akademik Feriz Krasniqi
3. Akademik Jusuf Bajraktari